



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/21 Ref.: 3d4/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
  - Bachelor i Muzikës në Performim, BMUS, 240 ECTS, me specializimet: Piano; 2) Këndim; 3) Dirigjim; 4) Instrumente me harqe dhe tela; 5) Instrumente frymore; maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Master i Muzikës në Performim, MMUS, 60 ECTS, me specializimet: 1) Piano; 2) Këndim; 3) Dirigjim; 4) Instrumente me harqe dhe tela; 5) Instrumente frymore; maksimumi 40 studentë për vit akademik;
  - Bachelor i Muzikës, BMUS, 240 ECTS, me specializimet: 1) Pedagogji e përgjithshme muzikore; 2) Kompozim; maksimumi 27 studentë për vit akademik (25 studentë në Pedagogji e përgjithshme muzikore dhe 2 në Kompozim);
- III. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tri (3) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Produkt Dizajn, BA, 180 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik;
  - Artet Dramatike, BA, 240 ECTS, me specializimet: 1) Aktrim, 2) Regji teatri, 3) Regji filmi dhe televizioni, 4) Dramaturgjia dhe skenar filmi, 5) Dizajn skene dhe Kostumografi, 6) Produksion, 7) Kamerë dhe Montazh; maksimumi 60 studentë për vit akademik;



- Artet Dramatike, MA, 60 ECTS, me specializimet: 1) Aktrim, 2) Regji teatri, 3) Regji filmi dhe televizioni, 4) Dramaturgjia dhe skenar filmi, 5) Dizajn skene dhe Kostumografi; maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- Artet Vizuale, BA, 240 ECTS, me specializimet: 1) Pikturë, 2) Grafikë, 3) Skulpturë, 4) Ilustrim dhe Vizatim; 5) Dizajn Komunikimi; 6) Dizajn i Inovacioneve; 7) Arti Konceptual dhe Mediat e Reja; maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- Artet Vizuale, MA, 60 ECTS, me specializimet: 1) Pikturë, 2) Grafikë, 3) Skulpturë, 4) Ilustrim dhe Vizatim; 5) Dizajn Komunikimi; 6) Dizajn i Inovacioneve; 7) Arti Konceptual dhe Mediat e Reja; maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- Master i Muzikës në Edukim Muzikor, MMUS, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- Master i Muzikës në Kompozim, MMUS, 120 ECTS, maksimumi 6 studentë për vit akademik.

IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

V. Obligohet Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Programi i studimit                                                                                                                                                              | Bartësit e programit                                                                                                                                  |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Bachelor i Muzikës në Performim,<br>BMUS, 240 ECTS,<br>Me specializimet: Piano; 2) Këndim; 3) Dirigjim; 4) Instrumente me harqe dhe tela; 5) Instrumente frymore;<br>Riakreditim | Betim Krasniqi<br>Lejla Pula<br>Venera Kajtazi<br>Fram Gashi<br>Alberta Troni<br>Sanije Matoshi<br>Edon Ramadani<br>Sihana Badivuku<br>Astrit Mustafa |
| 2   | Master i Muzikës në Performim,<br>MMUS, 60 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Piano; 2) Këndim; 3) Dirigjim; 4) Instrumente me harqe dhe tela; 5) Instrumente frymore<br>Riakreditim  | Antonio Gashi<br>Valbona Petrovci<br>Lule Elezi<br>Merita Juniku<br>Alma Bektashi<br>Arianit Shehu<br>Blerim Grubi<br>Shkumbin Bajraktari             |
| 3   | Bachelor i Muzikës,                                                                                                                                                              | Florita Raifi                                                                                                                                         |



|   |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                |
|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   | BMUS, 240 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Pedagogji e përgjithshme muzikore; 2) Kompozim<br>Riakreditim                                                                                                                                    | Misbah Kacamaku<br>Nezahate Shala<br>Kreshnik Aliçkaj<br>Drinor Zymberi<br>Zana Basha                                                                                                          |
| 4 | Produkt Dizajn,<br>BA, 180 ECTS,<br>Akreditim                                                                                                                                                                                            | Lyra Zajmi<br>Eliza Hoxha<br>Ardita Byci                                                                                                                                                       |
| 5 | Artet Dramatike,<br>BA, 240 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Aktrim, 2) Regji teatri, 3) Regji filmi dhe televizioni, 4) Dramaturgjia dhe skenar filmi, 5) Dizajn skene dhe Kostumografi, 6) Produksion, 7) Kamerë dhe Montazh<br>Akreditim | Emin Emini<br>Ekrem Xani<br>Arian Krasniqi<br>Besim Rexhaj<br>Hazir Haziri<br>Arbëneshë Nixha<br>Elmaze Nura<br>Zymber Kelmendi<br>Burim Gora<br>Jeton Ahmetaj<br>Besar Zahiti                 |
| 6 | Artet Dramatike,<br>MA, 60 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Aktrim, 2) Regji teatri, 3) Regji filmi dhe televizioni, 4) Dramaturgjia dhe skenar filmi, 5) Dizajn skene dhe Kostumografi,<br>Akreditim                                       | Agnes Nokshiqi<br>Astrit Kabashi<br>Agim Selimi<br>Seadet Beqiri<br>Zeni Ballazhi<br>Ismet Sijarina<br>Drita Begolli                                                                           |
| 7 | Artet Vizuale,<br>BA, 240 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Pikturë, 2) Grafikë, 3) Skulpturë, 4) Ilustrim dhe Vizatim; 5) Dizajn Komunikimi; 6) Dizajn i Inovacioneve; 7) Arti Konceptual dhe Mediat e Reja<br>Akreditim                    | Valbona Rexhepi<br>Visar Mulliqi<br>Basri Mekolli<br>Agron Bytyci<br>Valdetë Velu<br>Sabri Shaqiri<br>Eshref Qahili<br>Mjellma Goranci<br>Genc Reznici<br>Bardhyl Bejtullahu<br>Mehmet Behluli |
| 8 | Artet Vizuale,<br>MA, 60 ECTS,<br>Me specializimet: 1) Pikturë, 2) Grafikë, 3) Skulpturë, 4) Ilustrim dhe Vizatim; 5) Dizajn Komunikimi; 6) Dizajn i Inovacioneve; 7) Arti Konceptual dhe Mediat e Reja<br>Akreditim                     | Ismet Jonuzi<br>Majlinda Kelmendi<br>Mirsad Lushtaku<br>Guri Cavdarbasha<br>Suad Rama<br>Muhamet Ahmeti<br>Vlora Ismaili<br>Adem Rusinovci                                                     |
| 9 | Master i Muzikës në Edukim Muzikor,<br>MMUS, 120 ECTS,<br>Akreditim                                                                                                                                                                      | Besa Luzha<br>Rreze Kryeziu Breznica                                                                                                                                                           |



|    |                                                               |                                      |
|----|---------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| 10 | Master i Muzikës në Kompozim,<br>MMUS, 120 ECTS,<br>Akreditim | Valton Beqiri<br>Dafina Zeqiri Nushi |
|----|---------------------------------------------------------------|--------------------------------------|

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar tri vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 19.03.2021, 07.05.2021 dhe 28.05.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Diana Milcic, Marina Novak, Oana Sarbu, Ketj Tsotniashvili.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Bachelor i Muzikës në Performim, BMUS, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht dy (2), substancialisht dy (2), pjesërisht dy (2) dhe nuk përmbush një (1) prej tyre.
2. Për programin e studimit Master i Muzikës në Performim, MMUS, 60 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht dy (2), substancialisht dy (2), pjesërisht dy (2) dhe nuk përmbush një (1) prej tyre.
3. Për programin e studimit Bachelor i Muzikës, BMUS, 240 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht një (1), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht tri (3) prej tyre.
4. Për programin e studimit Produkt Dizajn, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
5. Për programin e studimit Artet Dramatike, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
6. Për programin e studimit Artet Dramatike, MA, 60 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
7. Për programin e studimit Artet Vizuale, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
8. Për programin e studimit Artet Vizuale, MA, 60 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
9. Për programin e studimit Master i Muzikës në Edukim Muzikor, MMUS, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht një (1), substancialisht tre (3) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.
10. Për programin e studimit Master i Muzikës në Kompozim, MMUS, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht një (1), substancialisht tre (3) dhe pjesërisht tre (3) prej tyre.




Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

